




Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Zyra e kryetarit të komunës

Në mbështetje nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 12 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, shpall:

KONKURS

Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria për Urbanizëm, Mbrojtje dhe Mjedis- Komuna e Vushtrrisë

Vendi i punës: Sistemimi i adresave në Komunën e Vushtrrisë

Lloji i pozitës: Marrëveshje për shërbime të veçanta (kohëzgjatja 6 muaj, pa mundësi vazhdimi)

Orari i plotë: 40 orë në javë

Paga: 291.36 euro

Qëllimi i vendit të punës:

Vendosja e adresave në territorin e komunës së Vushtrrisë;

Numri i ekzekutuesve: 1

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi;

- Vendosja e emrave të rrugëve;
- Vendosja dhe digjitalizimi i numrave të objekteve;
- Digjitalizimi i rrugëve të reja;
- Kryen edhe detyra tjera që i cakton Drejtori i Drejtorisë.

Kualifikimi profesional dhe aftësitë:

Shkolla e mesme nga : ndërtimtaria ose arkitektura.

Përvoja e mëhershme në sistemin e adresave konsiderohet përparësi.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik, nga data 29.07.2017 deri më datë 05.08.2017.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: **Kopjen e vërtetuar të diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën ose ekstraktin e lindjes, certifikatën nga Gjykata që nuk është nën hetime, si dhe dëshmi mbi trajnimet e kryera. Duhet të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. 028-572-416.



Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku